



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:278060

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05509299

AA.nr.707/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Hajriz Hoti dhe Delushe Halimi anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Besarta Sopaj, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit A.R-Gjilan, përfaqësuar nga M.R, Komuna Gjilan, kundër të paditurës, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve- Departamenti i Pensioneve, e cila përfaqësohet nga Avokatura Shtetërore pranë Ministrisë së Drejtësisë, me bazë juridike anulimi i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.831/2019 të datës 25.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Administratës Pensionale me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.831/2019 i datës 25.08.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.831/2019 të datës 25.08.2023, nën pikën I të dispozitivit është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.R-Gjilan, kundër të paditurës Ministria e Financave Punës

dhe Transfereve- Departamenti i Pensioneve. Në pikën II të dispozitivit është anuluar vendimi i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë/Departamenti i Pensioneve i datës 05.11.2018 dhe vendimi i datës 27.02.2019 dhe paditësit i njihet e drejta në kompensim retroaktiv për pension për persona me pa aftësi të përhershme nga data e ndërprerjes në procedurë të rivlerësimit datë 05.11.2018 deri më datë 25.08.2023, kurse nga data 26.08.2023 i njihet e drejta në pension të personave me paaftësi të përhershme deri më datë 25.08.2028 (në periudhë pesë vjeçare) dhe kompensimi bëhet në baza mujore për pension të personave me paaftësi të përhershme në shumën e cila aplikohet për këtë lloj pensioni. Në pikën III të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që paditëses t'ia kompensoj në mënyrë retroaktive pagesat mujore të papaguara në emër të kompensimit për pension të personave me paaftësi të përhershme në shumë mujore prej 75 (shtatëdhjetë e pesë) euro nga data 05.11.2018 deri më datë 12.01.2022, kurse nga data 13.01.2022 deri më datë 25.08.2023 shumën prej nga 100 (njëqind) euro në muaj, të gjitha këto në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit me dhunë. Në pikën IV të dispozitivit është vendosur që pas kalimit të afateve të përcaktuara në pikën II të dispozitivit paditësi i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit. Në pikën V të dispozitivit është vendosur që ky aktgjykim zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, Ministria e Drejtësisë - Avokatura Shtetërore, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës jokontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës dhe të anulohet aktgjykimin A.Nr.831/2019 i datës 25.08.2023 dhe çështjen ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala paditëse.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale/Departamenti i Administratës Pensionale (MPMS/DP) të Republikës së Kosovës, në Prishtinë, me vendimin me Nr. të dosjes 5010142 të datës 27.02.2019, e ka refuzuar ankesën e z/znj A.R, me numër të ID-së ... për njohjen e të drejtës në Pension me Pa aftësi të Përhershme, si e pa bazuar.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale/Departamenti i Administratës Pensionale (MPMS/DP) të Republikës së Kosovës, në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimit të lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale/Departamenti i Administratës Pensionale (MPMS/DP) të Republikës së Kosovës, në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Me arsyetim se, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur në përputhje me nenin 43 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadija e paditëses është e bazuar. Gjykata e shkallës së parë ka lejuar precizimin e kërkesës në shqyrtim gjyqësor. Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në neni 43.3 të Ligjit për Konflikte Administrative ka vendosur që meritorisht ta vendos këtë çështje administrative dhe për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike në këtë çështje, përkatësisht për ta përcaktuar paaftësisë të paditësit, ka caktuar marrjen e provës me ekspertizë mjekësore. Me vendimin e QKU të Kosovës janë caktuar ekspertë mjekësor për dhënien e mendimit profesional në përbërje të: Dr.A.A-psikiatër, Dr. T.K-psikiatër, Dr. F.A-neurolog të cilët kanë përshkruar në ekspertizë ekzaminimet e statusit mendor dhe neurologjik. Gjatë shqyrtimit gjyqësor ekspertja mjekësore Dr.T.K-psikiatër deklaroi: bazuar si në të dhënat hetero-anamnestike, raporteve mjekësore, dhe ekzaminimit direkt të pacientit, konstatojmë që shkalla e pa aftësisë sipas formulës së Baltazarit është 20%, me diagnozën “Retardim i lehtë mendor F70”, *kjo gjendje është e përhershme, e pa shërueshme, kronike, që ka filluar nga fëmijëria. Këto sëmundje qysh në moshën 2-3 vjeçare shihet se ka ngecje në zhvillim, kjo përbindje e bënë të pa aftë për punë dhe pa tjetër që i duhet mbështetje nga personi tjetër. Kjo pa aftësi është konstatuar nga Psikiatri, ndërsa statusi Neurologjik nga Neurologu ka qenë pa*

veçori patologjike. Nga vlerësimi i mendimit të komisionit mjekësor të QKUK-së, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se këtu paditësi ka paaftësi të kufizuar të përhershëm, paaftësia është qysh në moshën 2-3 vjeçare sipas konstatimit dhe deklaramentit të ekspertës mjekësore. Andaj gjykata e shkallës së parë duke pasur parasysh faktin se nga ekspertiza mjekësore konstatohet gjendja shëndetësore e paditësit dhe në shqyrtim gjyqësor deklarohet se paditësi ka paaftësi të kufizuar prej 20 %, se kjo paaftësi është e përhershme, është e shfaqur qysh nga mosha 2-3 vjeçare e lindjes dhe po ashtu se kjo përqindje e bënë të pa aftë për punë, është konstatuar se këtu paditësi ka kufizim të aftësisë dhe paaftësia është e përhershme, andaj paditësi plotëson kushtet ligjore, për njohjen e të drejtës në pensionin e personave me paaftësi të përhershme, i përcaktuar nga Ligji nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht nenin 9, paragrafët 1. Prandaj gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se në bazë të mendimit të dhënë nga Komisioni Mjekësor i QKUK-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, është vërtetuar se paditësi i plotëson kushtet për njohjen e pensionit për personat me paaftësi të përhershme përkatësisht kriteret nga neni 9 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti dhe mbi këto arsye edhe vendimi kontestues e konstaton si jo të drejtë dhe jo të ligjshëm. Me nenin 2 paragrafi 2.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore përcaktohet:” Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”, i zbatueshëm në kuptim të nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me njohjen e të drejtës dhe kompensimin si në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij vendimi. Lidhur me periudhën e vendosjes si në pikën II të dispozitivit gjykata e shkallës së parë kishte parasysh nenin 20 paragrafi 1 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti ku përcaktohet ‘’Të gjitha pensionet që paguhen sipas këtij ligji, do të fillojnë të paguhen nga dita e parashtrimit të kërkesës’’, andaj gjykata e shkallës së parë kishte parasysh datën e ndërprerjes 05.11.2018 në procedurë të rivlerësimit, si periudhë e njohjes. Kurse njohjen e të drejtës së pensionit për paaftësi të përhershme në vazhdim dhe periudhën e njohjes Gjykata e vendosi në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti ku përcaktohet:” 5.3. Komisioni Mjekësor vlerëson paaftësinë në kohëzgjatje për periudhën prej një (1), tre (3) apo pesë (5) vitesh”. Lidhur me kompensimin e përcaktuar si në dispozitiv Gjykata e shkallës së parë kishte parasysh po ashtu nenin 26 të Ligjit për Konfliktet Administrative ku përcaktohet:” 2.3. kthimi i sendeve të marrura dhe kompensimi i dëmit i shkaktuar me ekzekutimin e aktit administrativ të kontestuar.”, dhe po ashtu nenin 46 të këtij Ligji ku përcaktohet:” 5. Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendosë edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do

ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore”. Lartësia e shumës së kompensimit u vendos në kuptim të shumës së përcaktuar për këtë lloj të pensionit, duke marrë për bazë dhe vendimit të Qeverisë në raport me rritjet përkatëse. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe pretendimet e të paditurës dhe konstaton se të njëjtat janë të pa bazuara, sepse me provat e administruara, në kuptim të dispozitës së nenit 9 Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, është vërtetuar se paditësi i plotëson kushtet ligjore për njohjen e të drejtës së kërkuar.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë i'u ka referuar nenit 9 par.1 dhe 5 të Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Sepse me paragrafin 1 përcaktohet se: *“1. Pensioni i paaftësisë të përhershme do t’iu ofrojë mbështetje financiare personave të përzgjedhur në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë ligj, sipas mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Republikës së Kosovës”*. Kurse me paragrafin 5 të të njëjtit, përcaktohet se: *“5. Një person do të konsiderohet me pa aftësi të përhershme, nëse: 5.1. ofron dëshmi se është me pa aftësi të përhershme para se të aplikojë për pension, duke siguruar të gjitha dëshmitë mjekësore; 5.2. Komisioni Mjekësor vlerëson se ekziston pa aftësia e përhershme e punës te parashtruesi i kërkesës; 5.3. Komisioni Mjekësor vlerëson paaftësinë në kohëzgjatje për periudhën prej një (1), tre (3) apo pesë (5) vitesh; 5.4. Pas skadimit të afateve të përcaktuara në nën paragrafin 5.3 të këtij paragrafi personi i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor”*. Prandaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë konstaton se në bazë të ekspertizës dhe mendimit të dhënë nga Komisioni Mjekësor i QKUK-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor vërtetohet se paditësi i plotëson kushtet për njohjen e pensionit për personat me paaftësi të përhershme, përkatësisht kriteret nga neni 9 i Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gjykata Themelore në Prishtinë nuk u bazua në faktet e dhëna nga e paditura, kështu gjendjen faktike e nxori komplet nga provat e paditësit që ishte jo e plotë dhe e gabuar, kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi ngase vlerëson se janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara veç e veç dhe të gjitha së bashku, me të drejtë i ka falë besimin provave të administruara në seancë, me të cilat konstatohet se si paditësi është e paaftë për punë, dhe gjendja, sëmundja apo aftësia e kufizuar është e përhershme. Po ashtu gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka krijuar bindjen e saj nga ekspertiza e nxjerrë nga grupi i ekspertëve pranë QKUK-së e nxjerrur për paditësin në përbërje prej tre (3) profesionistëve të fushave përkatëse të caktuar e ku nga e njejta konstatohet se ekspertet pasi kanë ekzaminuar pacientin/paditësin, shkresat e lëndës, kanë nxjerrë përfundim se si pacienti ka paaftësi për punë dhe se nga kjo gjendje është person me paafsi të përhershme.

Kolegji i kësaj gjykate ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera ankimore të paditurës, se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale dhe nëse do të kishte evituar shkeljet e lartcekura atëherë do të mund të aplikonte edhe të drejtën materiale, sepse për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nuk mund të bëhet zbatimi i drejtë i të drejtës materiale, mirëpo të njëjtat nuk i aprovoi, ngase të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara me prova konkrete të cilat do të gjenin mbështetje ligjore, dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimit i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të

paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AA.nr.707/2023, me datë 06.03.2024

Kryetari i kolegjit,

Ramiz Kuqi